



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.65

2004

15 shtator

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.578, datë 27.8.2004	Për një shtesë në vendimin nr.322, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre"	4059
Vendim i KM nr.579, datë 27.8.2004	Për miratimin e modelit të dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë.....	4059
Vendim i KM nr.580, datë 10.9.2004	Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integrimit European....	4073
Vendim i KM nr.583, datë 10.9.2004	Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia.....	4075
Vendim i KM nr.585, datë 10.9.2004	Për shpërndarjen e parakohshme të këshillit të komunës Dushk...	4075
Vendim i KM nr.586, datë 10.9.2004	Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror.....	4075

Vendim i KM nr.587, datë 10.9.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Krumës.....	4076
Vendim i KM nr.596, datë 10.9.2004	Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij	4077
Vendim i KM nr.601, datë 10.9.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Libohovës.....	4084
Vendim i KM nr.602, datë 10.9.2004	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Burrelit.....	4084

VENDIM
Nr.578, datë 27.8.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.322, DATË 21.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA
INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT
TË ÇMIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.322, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Masa e mbulimit të çmimit të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për kategorinë e pensionistëve të jetë 100 për qind."

2. Efektet financiare për vitin 2004 të përballohen nga fondi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 28.5.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.579, datë 27.8.2004

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË DOKUMENTIT TË IDENTITETIT TË SHTETASVE
SHQIPTARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të dokumentit të identitetit, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano





■ STANDARTET GRAFIKE TE DOKUMENTIT

■ ELEMENTET BIOMETRIKE

PODOKRATA E ANALIZIMIT ME MENDYRA

IRIMIA E IDENTITIT

PERBERESIT E GJENDJES CIVILE

IRIMI

IRIMI

IRIMI

IRIMI

IRIMI

IRIMI IDENTITIT

ELEMENTET E SIGURISE

IRIMI E IDENTITIT

IRIMI

PODOKRATA E ANALIZIMIT ME MENDYRA

IRIMI IDENTITIT

PODOKRATA E ANALIZIMIT ME MENDYRA

IRIMI IDENTITIT

IRIMI IDENTITIT

IRIMI IDENTITIT

Mbajtja e dokumentit të identitetit është e detyrueshme për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Si i tillë dokumenti i identitetit përmban elemente sigurie dhe *design* të ndërthurura me njëra-tjetrën. Qëllimi i këtij projekt-*design* është që ta kthejë dokumentin e "detyruar" në një objekt dëshire dhe krenarie për mbajtësin. Këtë qëllim projekt-*design* i mëposhtëm mundohet ta arrijë nëpërmjet raporteve grafike, gjeometrike të simboleve, imazheve dhe elementeve grafike të ndryshëm në kartë.

Simboli kryesor është shqiponja (pjesë e stemës së Republikës) dhe përkrenarja, e cila ndodhet në qendër të shqiponjës. Raportet e elementeve të dokumentit janë krijuar në mënyrë që elementi i parë mbizotërues të jetë holograma (shqiponja). E vendosur djathtas-sipër grafikisht ajo e kërkon barazinë grafike në shiritin kuq e zi mbizotërues në pjesën sipërme të kartës.

Të dy këto elemente barazohen grafikisht me të dy fotot e mbajtësit. Kështu që përbërësit e gjendjes civile bëhen në të vërtetë dominuesit në dokument.

Pra shtetasi (zotëruesi i dokumentit ose nëpunësi i gjendjes civile) merr në mënyrë të pavetëdijshme vlerën morale që ka dokumenti dhe më pas mund të marrë informacionin e nevojshëm.

Në pjesën e pasme raportet grafike janë më të thjeshta, pasi në të do të vendoset barcode dhe informacione të tjera të rëndësishme, dhe mbi të gjitha kjo varet nga teknologjia e printimit mbi kartë (lloji i printimit, fonti etj).

Fonti i zgjedhur për t'u përdorur në kartë është *Bell Gothic* (light, black), i cili hyn në familjen e fonteve sans serif (pa kthesa). *Bell Gothic* është një font i lexueshëm qartë dhe mjaft ekonomik (lejon përdorimin në hapësirat e vogla të kartës). Ngjyra e përdorur për të është e zeza.

Shtresa holografike, e cila do të krijojë iluzionin e një refleksi mbi kartë, është pjesë e hartës së Europës. Në të është fokusuar vendndodhja e shtetit shqiptar. Në të vërtetë ngarkesa grafike e shtresës holografike është gati e papërfillshme për të ndërhyrë në *design-in* e dokumentit të identitetit.

a) Pamja e parë e hologramës është përkrenarja e Skënderbeut (sipas stemës së Republikës) në qendër të shqiponjës.

b) Pamja e dytë është shqiponja, e cila përshkohet nga vija paralele dhe një fashetë në këndin 45°, e cila kufizohet nga i njëjti mikrotekst i dokumentit. Në pjesën e zemrës së shqiponjës ndodhet një tjetër shqiponjë e vogël.

Sfondi është i përbërë nga tre elemente:

a) Baza (rainbow);

b) Shqiponja e cila ka ngjyrën më të fortë të teknikës rainbow;

c) Strip (e kundërta e bazës).

Shenja UV është njëloj me hologramën dhe vendosja e saj në kartë është në të njëjtën lartësi mbi hologramën. Ajo ndodhet midis fotos me ngjyra dhe hologramës.

Studioja që realizoi design e dokumentit është Studio Grafike Elsi Kongo. Kjo studio u përzgjedh nga konkursi kombëtar i organizuar nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit "Disenjimi i dokumentit të identitetit". Në këtë konkurs morën pjesë 43 studio grafike, prej të cilave 9 arritën të paraqesin modelin e tyre për *design-in* e dokumentit të identitetit.

Në faqen tjetër janë paraqitur dy pamjet e dokumentit.




LEGGI IL TESTO COMPLETO DEL LIBRO

8




PERFARM



PERFARM

PERMASAT







FRANCESCO MANTUANO


1

MODULET



NGJYRAT


RAINBOW



© 2004 Blackwell Publishing Ltd *Journal of Internal Medicine* 255: 103–110

Podobni jardi najpogostejše v uporabi so na kar 1000 m².

1000



Introduction



BELL GOTHIC light
 abcdefghijklmnopqrstuvwxyz
 ABCDEFGHIJKLMNOPQRSTUVWXYZ
 0123456789!>>?@#%&*()
 11/11/11

2010-01-01
 2010-01-01
 2010-01-01



SHTRESA HOLOGRAFIKE

Matematika-kompetensi, yang akan diuji meliputi kemampuan menguraikan, memahami, menerapkan, menganalisis, dan mengevaluasi konsep-konsep matematika yang berkaitan dengan materi tersebut. Untuk itu, soal tes yang disajikan dalam bentuk uraian yang menuntut kemampuan analisis dan evaluasi.



Ergebnisse in Prozenten der Haushalte in Prozenten

© 2006 Pearson Education, Inc. All rights reserved.



[a] Paragja in pusti štitiš pili-krmurja in liščekar-kosa. [ajgas, v četrty offspaid štiti]

1998, 1999, 2000, 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025, 2026, 2027, 2028, 2029, 2030, 2031, 2032, 2033, 2034, 2035, 2036, 2037, 2038, 2039, 2040, 2041, 2042, 2043, 2044, 2045, 2046, 2047, 2048, 2049, 2050, 2051, 2052, 2053, 2054, 2055, 2056, 2057, 2058, 2059, 2060, 2061, 2062, 2063, 2064, 2065, 2066, 2067, 2068, 2069, 2070, 2071, 2072, 2073, 2074, 2075, 2076, 2077, 2078, 2079, 2080, 2081, 2082, 2083, 2084, 2085, 2086, 2087, 2088, 2089, 2090, 2091, 2092, 2093, 2094, 2095, 2096, 2097, 2098, 2099, 2100, 2101, 2102, 2103, 2104, 2105, 2106, 2107, 2108, 2109, 2110, 2111, 2112, 2113, 2114, 2115, 2116, 2117, 2118, 2119, 2120, 2121, 2122, 2123, 2124, 2125, 2126, 2127, 2128, 2129, 2130, 2131, 2132, 2133, 2134, 2135, 2136, 2137, 2138, 2139, 2140, 2141, 2142, 2143, 2144, 2145, 2146, 2147, 2148, 2149, 2150, 2151, 2152, 2153, 2154, 2155, 2156, 2157, 2158, 2159, 2160, 2161, 2162, 2163, 2164, 2165, 2166, 2167, 2168, 2169, 2170, 2171, 2172, 2173, 2174, 2175, 2176, 2177, 2178, 2179, 2180, 2181, 2182, 2183, 2184, 2185, 2186, 2187, 2188, 2189, 2190, 2191, 2192, 2193, 2194, 2195, 2196, 2197, 2198, 2199, 2200, 2201, 2202, 2203, 2204, 2205, 2206, 2207, 2208, 2209, 2210, 2211, 2212, 2213, 2214, 2215, 2216, 2217, 2218, 2219, 2220, 2221, 2222, 2223, 2224, 2225, 2226, 2227, 2228, 2229, 2230, 2231, 2232, 2233, 2234, 2235, 2236, 2237, 2238, 2239, 2240, 2241, 2242, 2243, 2244, 2245, 2246, 2247, 2248, 2249, 2250, 2251, 2252, 2253, 2254, 2255, 2256, 2257, 2258, 2259, 2260, 2261, 2262, 2263, 2264, 2265, 2266, 2267, 2268, 2269, 2270, 2271, 2272, 2273, 2274, 2275, 2276, 2277, 2278, 2279, 2280, 2281, 2282, 2283, 2284, 2285, 2286, 2287, 2288, 2289, 2290, 2291, 2292, 2293, 2294, 2295, 2296, 2297, 2298, 2299, 2300, 2301, 2302, 2303, 2304, 2305, 2306, 2307, 2308, 2309, 2310, 2311, 2312, 2313, 2314, 2315, 2316, 2317, 2318, 2319, 2320, 2321, 2322, 2323, 2324, 2325, 2326, 2327, 2328, 2329, 2330, 2331, 2332, 2333, 2334, 2335, 2336, 2337, 2338, 2339, 2340, 2341, 2342, 2343, 2344, 2345, 2346, 2347, 2348, 2349, 2350, 2351, 2352, 2353, 2354, 2355, 2356, 2357, 2358, 2359, 2360, 2361, 2362, 2363, 2364, 2365, 2366, 2367, 2368, 2369, 2370, 2371, 2372, 2373, 2374, 2375, 2376, 2377, 2378, 2379, 2380, 2381, 2382, 2383, 2384, 2385, 2386, 2387, 2388, 2389, 2390, 2391, 2392, 2393, 2394, 2395, 2396, 2397, 2398, 2399, 2400, 2401, 2402, 2403, 2404, 2405, 2406, 2407, 2408, 2409, 2410, 2411, 2412, 2413, 2414, 2415, 2416, 2417, 2418, 2419, 2420, 2421, 2422, 2423, 2424, 2425, 2426, 2427, 2428, 2429, 2430, 2431, 2432, 2433, 2434, 2435, 2436, 2437, 2438, 2439, 2440, 2441, 2442, 2443, 2444, 2445, 2446, 2447, 2448, 2449, 2450, 2451, 2452, 2453, 2454, 2455, 2456, 2457, 2458, 2459, 2460, 2461, 2462, 2463, 2464, 2465, 2466, 2467, 2468, 2469, 2470, 2471, 2472, 2473, 2474, 2475, 2476, 2477, 2478, 2479, 2480, 2481, 2482, 2483, 2484, 2485, 2486, 2487, 2488, 2489, 2490, 2491, 2492, 2493, 2494, 2495, 2496, 2497, 2498, 2499, 2500, 2501, 2502, 2503, 2504, 2505, 2506, 2507, 2508, 2509, 2510, 2511, 2512, 2513, 2514, 2515, 2516, 2517, 2518, 2519, 2520, 2521, 2522, 2523, 2524, 2525, 2526, 2527, 2528, 2529, 2530, 2531, 2532, 2533, 2534, 2535, 2536, 2537, 2538, 2539, 2540, 2541, 2542, 2543, 2544, 2545, 2546, 2547, 2548, 2549, 2550, 2551, 2552, 2553, 2554, 2555, 2556, 2557, 2558, 2559, 2560, 2561, 2562, 2563, 2564, 2565, 2566, 2567, 2568, 2569, 2570, 2571, 2572, 2573, 2574, 2575, 2576, 2577, 2578, 2579, 2580, 2581, 2582, 2583, 2584, 2585, 2586, 2587, 2588, 2589, 2590, 2591, 2592, 2593, 2594, 2595, 2596, 2597, 2598, 2599, 2600, 2601, 2602, 2603, 2604, 2605, 2606, 2607, 2608, 2609, 2610, 2611, 2612, 2613, 2614, 2615, 2616, 2617, 2618, 2619, 2620, 2621, 2622, 2623, 2624, 2625, 2626, 2627, 2628, 2629, 2630, 2631, 2632, 2633, 2634, 2635, 2636, 2637, 2638, 2639, 2640, 2641, 2642, 2643, 2644, 2645, 2646, 2647, 2648, 2649, 2650, 2651, 2652, 2653, 2654, 2655, 2656, 2657, 2658, 2659, 2660, 2661, 2662, 2663, 2664, 2665, 2666, 2667, 2668, 2669, 2670, 2671, 2672, 2673, 2674, 2675, 2676, 2677, 2678, 2679, 26

Isi Pustaka ini ditulis melalui observasi dan data yang diperoleh juga pada saat ini.

[illegible]

GUILLOCH







SFONDI

Ubravi (izbriši) piktogrami sga in slovenski

- a) Baza (piktogram)
- b) Skupnost in stila in njegovi stilski barvi in intervali, in izdati
- c) Lirija (in izdati in izdati)



MIKROTEKST



SHENJIA.UV

Iskanya lili dila di rjibakaj van halagawadla, dila zandaka n ija rei kariti kela-dil id ajij dila
kariti raki halagawadla . Ija mabidhi n idla kila marigga dila halagawadla



VENDIM
Nr.580, datë 10.9.2004

PËR FUSHËN E VEPRIMTARISË SË MINISTRISË SË INTEGRIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Integrimit European, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Integrimit European ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European, hartimit të politikave të integrimit, bashkërendimit të ndihmave financiare dhe informimit të publikut për këtë proces.

2. Ministria e Integrimit European ushtron këto veprimtari:

a) Bashkërendon punën dhe monitoron përgatitjet e institucioneve shqiptare dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të stabilizim-asocimit;

b) Bashkërendon, monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit European, të dala nga takimet e përbashkëta me Bashkimin European, në nivele të ndryshme;

c) Përgatit mekanizmat metodologjikë në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektorale, që rrjedhin nga negocimi dhe zbatimi i marrëveshjes së stabilizim-asocimit;

ç) Bashkërendon punën ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore për hartimin e planeve kombëtare për partneritetin european, me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuar në kuadër të procesit të integrimit european;

d) Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European, duke mbajtur lidhje të rregullta institucionale me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore;

dh) Harton, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, planin kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European, si dhe kontrollon zbatimin e këtij plani dhe të programeve të tjera të lidhura me partneritetin european;

e) Vlerëson përputhshmërinë e projektakteve normative të propozuara nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore me të drejtën e Bashkimit European, të cilat duhet të pasqyrojnë në relacionin shoqëruar, shkallën e përafrimit dhe referencat për legjislacionin përkatës dhe jurisprudencën e Komunitetit European;

ë) Bashkërendon punën dhe ndihmon ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e stabilizim-asocimit;

f) Konfirmon përkthimin e dokumentacionit bazë, të nevojshëm për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European;

g) Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën komunitare për Republikën e Shqipërisë (programi CARDS, programi i fqinjësisë, TAIEK, si dhe programe të tjera ndihme, që mund t'i ofrohen Republikës së Shqipërisë), sipas përparësive të vendit tonë, në kuadër të procesit të integrimit european;

gj) Përgatit dhe ndjek nënshkrimin e marrëveshjeve të ndihmave financiare të Bashkimit European për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programeve të përcaktuara në shkronjën "g" të kësaj pike;

h) Udhëheq dhe bashkërendon punën e ministrive të linjës dhe të institucioneve të tjera qendrore në përgatitjen e projekteve parësore dhe, në kuadër të programeve të përcaktuara në shkronjën "g", ia paraqet për mbështetje financiare Bashkimit European;

i) Merr pjesë në veprimtarinë e grupeve të punës, të ngritura nga institucione të tjera shtetërore, për hartimin e programeve të ndryshme për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European;

j) Shkëmben të dhëna dhe organizon takime periodike, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në funksion të procesit të integrimit europian.

3. Ministria e Integrimit Europian në marrëdhëniet me të tretët:

a) bashkërendon hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e integrimit europian;

b) propozon ngritjen e grupeve teknike të punës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga procesi i integrimit europian;

c) kërkon nga ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore përgatitjen dhe paraqitjen në afate të caktuara të dokumenteve, në funksion të procesit të integrimit europian;

ç) njofton organet përkatëse të Bashkimit Europian për përafrimin e akteve normative vendase me të drejtën e Bashkimit Europian;

d) përgatit dhe paraqet raporte për procesin e integrimit europian në Komitetin Ndërmnistror të Integrimit;

dh) informon komisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të interesuara për procesin e integrimit europian, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese.

4. Mënyra e komunikimit të Ministrisë së Integrimit Europian me misionin shqiptar pranë Bashkimit Europian të rregullohet nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Integrimit Europian.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.583, datë 10.9.2004

PËR CAKTIMIN E NIVELIT BAZË TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 të ligjir nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Niveli bazë i të ardhurës nga papunësia të jetë 4360 (katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

3. Vendimi nr.631, datë 18.9.2003 i Këshillit të Ministrave "Për rritjen e nivelit të pagesës së papunësisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.9.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.585, datë 10.9.2004

PËR SHPËRNDARJEN E PARAKOHSHME TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DUSHK

Në mbështetje të neneve 100 e 115 pika 1 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 38 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shpërndarjen e parakohshme të këshillit të komunës Dushk, i cili nuk është mbledhur për një periudhë të vazhdueshme tremujore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.586, datë 10.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Autoritetit Portual, Durrës" sh.a.

Lista 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.

2. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Vlorë" sh.a.

Lista 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 14 (katërmëdhjetë) fletë.

3. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Shëngjin" sh.a.

Lista 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 2 (dy) fletë.

4. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar, Sarandë" sh.a.

Lista 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 3 (tri) fletë.

5. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ndërmarrjes "Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Durrës".

Lista 5 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 2 (dy) fletë.

6. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Ndërmarrjes së Kontrollit të Shërbimit të Mjeteve Ujore, Vau i Dejës".

Lista 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.

7. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Regjistrin Detar Shqiptar, Durrës" sh.a.

Lista 7 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 1 (një) fletë.

8. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ndërmarrjes "Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, Tiranë".

Lista 8 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 1 (një) fletë.

9. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Aeroporti "Nënë Tereza", Tiranë" sh.a.

Lista 9 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 4 (katër) fletë.

10. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, Tiranë" sh.a.

Lista 10 që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 5 (pesë) fletë.

Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, Ministri i Ekonomisë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.587, datë 10.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË E KRUMËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Krumës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM
Nr.596, datë 10.9.2004

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL Durrës DHE PËR
RIORGANIZIMIN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 9 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Autoriteti Portual Durrës të riorganizohet dhe të funksionojë sipas këtij statuti.
 3. Vendimi nr.970, datë 12.9.1996 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë anonime të Autoritetit Portual të portit të Durrësit", shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI
AUTORITETIT PORTUAL Durrës

Neni 1
Emërtimi dhe selia

Autoriteti Portual Durrës në mbështetje të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual" riorganizohet nëpërmjet transformimit të ish-ndërmarrjes shtetërore të "Portit Detar Durrës" dhe në vijim të shoqërisë anonime "Autoriteti Portual Durrës", e krijuar me vendimin nr.907, datë 9.12.1996 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë anonime të Autoritetit Portual të portit të Durrësit".

Selia e Autoritetit Portual Durrës është në qytetin e Durrësit.

Neni 2
Objekti i Autoritetit Portual Durrës

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës është:

- Të bëjë të frytshëm dhe më të orientuar në drejtim të ekonomisë së tregut Autoritetin Portual, të rrisë konkurrencën, të zhvillohet ekonomikisht përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat, për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe modernizimin e portit.
- Të shndërrojë portin nga "port shërbimi" në "port administrues toke", për të rritur pavarësinë tregtare të portit.
- Të përafrojë shërbimet dhe infrastrukturën portuale me praktikat ndërkombëtare, për standarde të njëjta ndërmjet shteteve.
- Të sigurojë nivel shërbimesh të shkallës së lartë, në mënyrë që të plotësojë me një kosto të arsyeshme nevojat e përdoruesve.
- Të garantojë një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtje të mjedisit.
- Të sigurojë një shkallë të lartë pavarësie për menaxhimin e portit, si dhe për operatorë të ndryshëm, që kryejnë shërbimet në port.

- Të sigurojë qiradhënie ose koncesion për disa pajisje të caktuara për veprimtarinë e portit.
- Të bashkërendojë veprimtarinë detare dhe sistemin e transportit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Pasuria e Autoritetit Portual Durrës

Pasuria e Autoritetit Portual Durrës, në mbështetje të nenit 50 pika 1 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, përbëhet nga të gjitha pronat e paluajtshme dhe të luajtshme të trashëguara nga shoqëria anonime e Autoritetit Portual Durrës, e krijuar me vendimin nr.907, datë 9.12.1996 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë anonime të Autoritetit Portual të portit të Durrësit”.

Neni 4

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës janë:
 - a) Këshilli Drejtues
 - b) Drejtoria Ekzekutive
2. Organet e Autoritetit Portual Durrës ndihmohen dhe këshillohen nga Këshilli Konsultativ i Portit.

Neni 5

Përbërja dhe emërimi i Këshillit Drejtues

1. Përbërja e Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, sipas nenit 11 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, është si më poshtë:
 - a) Dy përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit;
 - b) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë si përfaqësuese e pronës shtetërore;
 - c) Një përfaqësues i prefekturës së Durrësit;
 - d) Dy përfaqësues nga sektori privat, të propozuar nga Këshilli Konsultativ i portit. Këshilli Konsultativ i portit mund të propozojë më shumë se 2 persona, por Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit përzgjedh dhe emëron 2 prej kandidatëve.
2. Të gjithë anëtarët emërohen nga Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit me propozim të institucioneve përkatëse.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen për një afat jo më shumë se 3 vjet me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë statusin e punës me kohë të pjesshme.
4. Mbledhja e Këshillit Drejtues zhvillohet me më shumë se gjysmën e anëtarëve të këtij Këshilli. Në rast largimi të anëtarëve të Këshillit Drejtues, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me pikën 2 të këtij neni.
5. Këshilli Drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Kryetari zgjidhet nga përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
6. Këshilli Drejtues përcakton pagesën e anëtarëve, të kryetarit dhe të drejtorit ekzekutiv, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Kriteret për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë një stazh pune në transport mbi 5 vjet;
- Të kenë njohuri e përvojë të gjerë për menaxhimin e biznesit;
- Të kenë njohuri e përvojë në operacionet e portit ose në marinën tregtare.

Neni 7

Papajtueshmëria me postin e anëtarit të Këshillit Drejtues

Anëtar i Këshillit Drejtues nuk zgjidhet personi që:

- a) Nuk është shtetas shqiptar;
- b) Nuk është rezident në Shqipëri;
- c) Është kontraktues i një përdoruesi të Autoritetit Portual Durrës ose personi që është drejtor, nëpunës a i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të këtij Autoriteti Portual;
- d) Ka qenë i dënuar për vepra penale a kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;
- e) Është përjashtuar nga shërbimi civil;
- f) Ka konflikt interesash me detyrën.

Neni 8

Largimi nga detyra

Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit largon nga detyra anëtarin e Këshillit Drejtues kur:

- a) E shkarkon nga detyra për arsye se:
 - nuk vepron në përputhje me kërkesat e nenit 19 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe rregullat e parashikuara në këtë statut;
 - kryen vepra penale ose shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të veprimtarisë në port.
- b) E liron nga detyra kur:
 - jep dorëheqjen me shkrim;
 - i kufizohet zotësia për të vepruar ose vdes;
 - i mbaron mandati;
 - mbush moshën 65 vjeç.

Në rastin e pikës së fundit kur anëtari i Këshillit Drejtues mbush 65 vjeç, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit ka të drejtë ta lërë të vazhdojë funksionin e tij deri në mbarimin e mandatit.

Neni 9

Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual Durrës është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe ushtron të drejtat mbi pronën si “port administrues i pronës”.

2. Këshilli Drejtues harton, ndryshon dhe shfuqizon rregulloret e brendshme dhe vendimet që rregullojnë ecurinë e Autoritetit Portual.

3. Autoriteti Portual Durrës mund të marrë kredi vetëm për qëllime të portit. Propozimi i marrjes së kredisë diskutohet paraprakisht nga Këshilli Konsultativ i portit dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Autoriteti Portual Durrës nuk mund të hipotekojë apo të lërë si garanci pronën shtetërore që menaxhon apo administron. Garanci mund të lihet vetëm nga të ardhurat e kësaj prone.

4. Këshilli Drejtues i Autoritetit pasi merr mendimin e komisioneve teknike, financiare dhe të Këshillit Konsultativ të portit përcakton kritere të qarta të dhënies së koncesionit në përputhje me legjislacionin për koncesionet. Çdo rast koncesioni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Autoriteti Portual (Këshilli Drejtues) për arritjen e objektivave në investime të parashikuara në pikën 1 të nenit 24 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, ndërmerr masa të nevojshme për të investuar me fondet e veta në zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës portuale.

6. Autoriteti Portual Durrës (Këshilli Drejtues ose Drejtori Ekzekutiv, në varësi të kompetencave të deleguara nga Këshilli Drejtues, duke marrë më parë mendimin e Këshillit Konsultativ) nuk mund të shesë asnjërin nga pronat shtetërore që administron, pra mund:

a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje për shërbimet, ose të krijojë mundësi për t'i përdorur ato;

b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për këtë qëllim;

c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e portit për t'i ardhur në ndihmë portit.

7. Autoriteti Portual (Këshilli Drejtues ose Drejtori Ekzekutiv, në varësi të delegimit) cakton tarifatat për:

a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;

b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;

c) shërbimet e mësipërme sigurohen nga Autoriteti Portual Durrës ose nga një operator i autorizuar, ose një e drejtë e dhënë prej tij në lidhje me portin;

8. Këshilli Drejtues ose Drejtori Ekzekutiv në bazë të autorizimit (delegimit të kompetencës) të dhënë nga ky Këshill, cakton normën e interesit që kërkohet për pagesat e vonuara.

9. Tarifatat e caktuara nga Autoriteti Portual mbi bazën e pikës 7 të këtij neni, janë në nivel që i lejojnë atij të veprojë në baza vetëmbështetëse financiare dhe ato duhet të jenë të arsyeshme dhe të favorshme njëkohësisht për Autoritetin dhe operatorët.

10. Kur tarifatat janë propozuar nga një operator që punon në port, Autoriteti Portual Durrës, pas këshillimit me Këshillin Konsultativ të portit, caktojnë si rregull një kufi më të lartë të këtyre tarifave.

11. Tarifatat tavan të propozuara nga Autoriteti Portual Durrës, nuk duhet të rrezikojnë arritjet ekonomike dhe financiare të operuesit.

12. Kur cakton tarifatat, Autoritetit Portual Durrës ose operatorit të autorizuar nuk i lejohej të shkelë barazinë e subjekteve përdoruese.

13. Nuk përbën diskriminim, nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave apo të sasisë së të mirave që tregohen.

14. Këshilli Drejtues miraton pasqyrat financiare të vitit fiskal pararendës në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit. Këto pasqyra tregojnë pagesën e përgjithshme që u është bërë personave të mëposhtëm:

a) Anëtarëve të Këshillit Drejtues;

b) Drejtori Ekzekutiv;

c) Nëpunësit dhe punonjësit, kur shuma i kalon limitet e planifikuara.

15. Autoriteti Portual i paraqet Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit pasqyrat financiare të miratuara, sipas pikës 14, nga Këshilli Drejtues përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare.

Neni 10

Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të nëpunësve

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues dhe nëpunës i Autoritetit Portual Durrës, gjatë ushtrimit të përgjegjësisë dhe kryerjes së detyrës duhet:

a) Të veprojë me ndershmëri dhe përgjegjësi në interes të Autoritetit Portual;

b) Të jetë profesionist në realizimin e detyrave;

c) Të ndjekë hap pas hapi objektivin e kthimit të portit në një "port administrues toke", zbatimin e legjislacionit për Autoritetin Portual dhe rregullat e këtij statuti;

ç) Të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit, për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut;

d) Të realizojë shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të portit;

dh) Të respektojë rregullat e përcaktuara në legjislacionin e punës, si dhe kodin etik të sjelljes;

e) Të njohë mirë rregullat e legjislacionit detar në përgjithësi dhe veçanërisht legjislacionin për Autoritetin Portual dhe aktet e dala në bazë e për zbatim të tyre.

Neni 11

Mbledhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues, si rregull, mbledhet një herë në tre muaj.
2. Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual Durrës zhvillon mbledhjen vjetore jo më vonë se një muaj pas mbylljes së llogarive të Autoritetit Portual.
3. Mbledhjet vjetore të Autoritetit Portual janë të hapura për publikun dhe çdo mbledhje tjetër që gjykohej prej tij.
4. Autoriteti Portual Durrës bën njoftimin në gazetën kryesore dhe lokale, të paktën 30 ditë përpara mbledhjes, ku përcakton orën dhe vendin ku do të mbahet mbledhja dhe krijon mundësinë që pasqyrat financiare t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve.
5. Në mbledhjen vjetore Këshilli Drejtues siguron:
 - a) numrin e mjaftueshëm të kopjeve të pasqyrave financiare të Autoritetit Portual për personat e pranishëm në mbledhje;
 - b) që Drejtori Ekzekutiv dhe anëtarët e Këshillit Drejtues t'u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve për veprimtarinë e portit Durrës.

Neni 12

Emërimi i Drejtorit Ekzekutiv

1. Këshilli Drejtues emëron Drejtorin Ekzekutiv dhe zëvendësit e tij mbi bazën e propozimit të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit.
2. Drejtori Ekzekutiv emëron nëpunësit e tjerë dhe personelin e nevojshëm për menaxhimin e portit.
3. Drejtori Ekzekutiv nuk është anëtar i Këshillit Drejtues.

Neni 13

Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës përpara Këshillit Drejtues për drejtimin dhe administrimin e Autoritetit Portual Durrës. Ai bashkërendon punën për planifikimin dhe caktimin e burimeve të të ardhurave të departamenteve dhe të njësive të tjera.

Neni 14

Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit

1. Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv janë:
 - a) siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të portit;
 - b) zhvillon, zbaton dhe realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ligji nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual", si dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij;
 - c) përgatit dokumentacionin e Autoritetit Portual për burimet njerëzore dhe i administron këto burime;
 - d) përfaqëson Autoritetin Portual në Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe në marrëdhënie me të tretë;
 - e) siguron zbatimin e politikave të Autoritetit Portual Durrës dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë Autoritet;
 - f) nxit rritjen e nivelit dhe profesionalizmin në anëtarët e stafit të tij;
 - g) siguron të dhëna për Këshillin Drejtues për çështjet që lidhen me Autoritetin Portual dhe vë në dijeni Këshillin Drejtues për këto çështje dhe politikatat që lidhen me to;
 - h) zbaton detyrat e tjera të caktuara nga Këshilli Drejtues.
2. Drejtori Ekzekutiv është menaxheri i përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga Këshilli Drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.
3. Nëpunësit e njësive të tjera janë përgjegjës përballë Drejtorit Ekzekutiv.

4. Drejtori Ekzekutiv zbaton politika për forcimin e Autoritetit Portual dhe përgjegjësi, qartëson stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera, të drejtën e publikut për t'u informuar lidhur me aktivitetin e portit etj.

5. Drejtori Ekzekutiv, në mbështetje të kërkesave, i jep leje për të hyrë në port çdo personi që ushtron veprimtari në port.

6. Drejtori Ekzekutiv gjithashtu bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mëposhtme:

a) veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin (drejtimin e anijeve), transportin e pasagjerëve, ngarkim-shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

b) veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të mësipërme.

7. Drejtori Ekzekutiv lidh kontrata në emër të Autoritetit Portual.

8. Drejtori Ekzekutiv, në emër të Autoritetit Portual Durrës, në çdo mbledhje vjetore që organizohet sipas detyrimeve që përcakton neni 25 i ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual" lidhur me veprimtarinë ekonomiko-financiare të këtij Autoriteti, është i detyruar të paraqesë:

a) pasqyrat financiare krahasuese;

b) raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

c) ndonjë të dhënë tjetër për pozitën financiare të Autoritetit Portual.

9. Drejtori Ekzekutiv në emër të Autoritetit Portual Durrës ose operatori i autorizuar vendos tarifa të reja apo rishikon tarifat ekzistuese për magazinim ose ankorim, atij nuk i lejohet të bëjë dallime ndërmjet përdoruesve, si dhe duhet të njoftojë për tarifat e propozuara. Tarifat e reja hyjnë në fuqi pas 60 ditëve nga data e botimit në gazetën kryesore me tirazh më të lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe t'u dërgojë me ftesë ose me mjete elektronike aktorëve që ndikohen drejtpërdrejt nga tarifat e reja. Njoftimi duhet të përmbajë të paktën:

a) hollësitë e tarifave të propozuara;

b) specifikimin e tarifës që do të merret nga Autoriteti Portual Durrës;

c) adresën se ku duhet të paraqiten personat e interesuar.

10. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtën të shqyrtojë ankesat e ndryshme për dallime në vendosjen e tarifave. Ai është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankesës.

11. Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, në zbatim të neneve 46 dhe 47 të ligjit nr.9130, datë 9.8.2003 "Për Autoritetin Portual" ka të drejtë të shqyrtojë ankesat kundër gjobave për kundërvajtje administrative të vëna nga agjentët kontrollues në bazë të ligjit të mësipërm, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Ai është i detyruar ta shqyrtojë ankesën brenda 30 ditëve.

Neni 15

Krijimi dhe veprimtaria e Këshillit Konsultativ

1. Autoriteti Portual Durrës, në këshillim me Ministrin e Transportit dhe të Telekomunikacionit, krijon një Këshill Konsultativ me 11 anëtarë, nga sektori privat dhe shtetëror, ku shumicën e zë sektori privat. Këshilli Konsultativ këshillon Këshillin Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, kryesisht për këto veprimtari:

a) në caktimin dhe miratimin e tarifave të Autoritetit Portual dhe ndryshimet e tyre;

b) në nxjerrjen e urdhëresave, rregulloreve, kodeve, standardeve dhe rekomandimeve;

c) në marrjen e huave;

d) në mbikëqyrjen e shumëllojshmërisë dhe të cilësisë së veprimeve dhe shërbimeve në port, për të ruajtur konkurrencën ndërmjet operatorëve të ndryshëm.

Neni 16

Librat e llogarive dhe sistemet

1. Autoriteti Portual mban librat e llogarive sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 26 të ligjit nr.9130, datë 9.8.2003 “Për Autoritetin Portual” si më poshtë:

- a) ruan librat e llogarive dhe të raporteve llogaritëse;
- b) siguron kontrollin financiar dhe menaxherial, sistemet e kontrollit dhe praktikat menaxheriale të jenë në përputhje me ligjet në fuqi.

2. Librat e llogarive, regjistrimet, sistemet dhe praktikat mbahen dhe përpunohen në mënyrë që të japin garanci se:

- a) aktivët e Autoritetit Portual janë të siguruara dhe të kontrolluara;
- b) veprimet e Autoritetit Portual janë në përputhje me ligjet në fuqi;
- c) burimet njerëzore, financiare dhe fizike të Autoritetit Portual janë menaxhuar në mënyrë të frytshme dhe se operacionet e këtij autoriteti janë kryer realisht.

Neni 17

Konrolli i Autoritetit Portual Durrës

1. Organet shtetërore, në vertikalitetin hierarkik të tyre, si Këshilli i Ministrave (Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm), Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare (Autoriteti Detar) ushtrojnë kontroll mbi Autoritetin Portual për të përcaktuar nëse veprimet e tij janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Organet e tjera shtetërore, të specializuara kryesisht në kontrollin ekonomiko-financiar si Kontrolli i Lartë i Shtetit, kontroll-revizioni i Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit e deri te kontrolli i brendshëm i vetë Autoritetit Portual Durrës, ushtrojnë kontroll mbi aktivitetin ekonomiko-financiar periodik.

3. Organet e kontrollit, në përfundim të kontrollit u paraqet Këshillit Drejtues dhe Ministrin të Transportit dhe të Telekomunikacionit një raport për përfundimet e kontrollit dhe masat e sugjerimet, konform legjislacionit në fuqi, për përmirësimin e punës, kur këto janë të domosdoshme.

Neni 18

Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë

Autoriteti Portual Durrës për mbrojtjen e mjedisit dhe për të siguruar personat nga rreziku për jetën dhe për të siguruar materialet nga dëmtimi ose humbja në port, krijon dy shërbime të specializuara:

1. Shërbimin e mbrojtjes së mjedisit
2. Shërbimin e sigurisë

Këto dy shërbime janë pjesë e nëpunësve të Autoritetit Portual Durrës dhe në varësi të Drejtorit Ekzekutiv dhe veprojnë në bazë të rregulloreve respektive të miratuara sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar.

VENDIM
Nr.601, datë 10.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E LIBOHOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Libohovës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 32 (tridhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numrin rendor 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.602, datë 10.9.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË BASHKINË E BURRELIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Burrelit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 482 (katërqind e tetëdhjetë e dy).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 15.9.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë